

# **BULETINI METROLOGJIK**

---

Pasqyra e lëndës:

1. Aktivitet i Infrastrukturës të Cilësisë. ....	2
2. Trajnimi "Njohje me kërkesat e standardit ISO/IEC 17025:2017 dhe implementimi i tyre në Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë në DPM" .....	3
3. Pjesëmarrje në ndërkrahim në fushën e matjeve të presionit.....	4
4. Trajnimi "BIPM- TUBITAK UME project placement" .....	6
5. Miratimi i akteve nënligjore .....	7
6. Vendimet për autorizim: .....	7

## **I. Aktiviteti i Infrastrukturës të Cilësisë.**

**Zj. Erinda Piluri**  
**Zv. Drejtor i Përgjithshëm**

Një takim i përbashkët mes Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, institucioneve përgjegjëse për infrastrukturën e cilësisë, biznesit, pronësinë industriale dhe mbikëqyrjen e tregut u organizua në datë 22 shkurt 2022 me temë “Rëndësia e Infrastrukturës së Cilësisë dhe Pronësisë Industriale në Tregun e Brendshëm dhe Ndërkombëtar”,



**Figura 1.**

*Fjala përshëndetëse e Znj. Delina Ibrahimaj,  
Ministër i MFE-së*

Fokusi kryesor i këtij aktiviteti ishte zhvillimi i infrastrukturës së cilësisë dhe përgatitja e bizneseve për një treg më konkurrues, me qëllim mbrojtjen e konsumatorit, ofrimin e shërbimeve dhe produkteve cilësore sipas standardeve të BE.

Në takim u prezantua aktiviteti i Drejtorisë të Përgjithshme të Metrologjisë i cili u fokusua në disa çështje, ku përmendim:

“**Metrologjia**” si shkencë e matjeve e cila përbën një nga komponentët e infrastrukturës së cilësisë, e nevojshme në ç’do vend të zhvilluar. Politika e aktivitetit të DPM-së është zhvillimi i sistemit kombëtar të metrologjisë i harmonizuar me standardet evropiane për të plotësuar nevojat e vendit, harmonizimi i procedurave dhe rregulloreve teknike të vlerësimit të matjeve, me qëllim eliminimin e barrierave teknike për lëvizjen e lirë të mallrave. Ajo luan rol themelor në mbrojtjen e konsumatorëve dhe rritjen e cilësisë së jetës të qytetarëve.



**Figura 2.**

*Prezantimi i aktivitetit të DPM-së*

**DPM** është institucion i specializuar që zotëron aftësitë dhe ekspertizën e nevojshme për t’u përdorur si referencë për transmetueshmërinë e matjeve në Shqipëri dhe punon për zhvillimin e tre

drejtimeve të metrologjisë në vendin tonë: metrologjisë shkencore, industriale dhe metrologjisë ligjore.

Një ndër misionet e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë është mbrojtja e konsumatorëve, nëpërmjet organizimit të kontrollit të instrumenteve matës në fushat e transaksioneve zyrtare dhe tregtare, mbrojtjes së shëndetit, mjedisit dhe sigurisë teknike, si dhe kontrollit sasior të parapaketimeve.

Matjet janë thelbësore në të gjitha proceset pasi rrisin në mënyrë të ndjeshme vlerën, efektivitetin dhe cilësinë e një produkti. Për këtë është e nevojshme që të gjitha proceset të përdorin instrumente matës të saktë dhe të besueshëm.

DPM siguron gjurmueshmërinë e matjeve në vendin tonë në ato të nivelit ndërkombëtar nëpërmjet një sistemi etalonesh matjeje kombëtar dhe referencë, si dhe jep mbështetje teknike për madhësitë fizike dhe kimike të ndryshme brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Aktualisht, aftësitë matëse dhe kalibruese (CMC) të laboratorit të masës, volumeve dhe presionit janë publikuar në Byronë Ndërkombëtare të Peshave dhe Masave (BIPM). Çertifikatat e kalibrimit të lëshuara nga këta laboratorë njihen ndërkombëtarisht.

DPM do vazhdojë të organizojë aktivitete për të promovuar shërbimet e saj.

**2.Trajnimi "Njohje me kërkesat e standardit ISO/IEC 17025:2017 dhe implementimi i tyre në Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë në DPM".**

**Znj. Majlinda Hoxha  
Përgjegjëse e Sektorit të Sigurimit të Cilësisë**

Në datat 7-8.10.2021 në ambientet e Drejtorisë të Përgjithshme të Metrologjisë u organizua trajnimi "Njohje me kërkesat e standardit ISO/IEC 17025:2017 dhe implementimi i tyre në Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë në DPM", i cili pati si audiencë specialistët e rinj të laboratorëve kalibrues të DMSHI-së.



**Figura 3.**

*Prezantim i kërkesave të standartit*

Gjatë trajnimit, përveç prezantimit të kërkesave teknike të standardit ISO/IEC 17025:2017, nga lektorja, u diskutuan edhe raste praktike nga pjesmarrësit të implementimit të kërkesave në praktikat kalibruese. Në fund të trajnimit, pjesmarrësit morën çertifikatë trajnimi.

### 3.Pjesëmarrje në ndërkrahasim në fushën e matjeve të presionit

#### Z. Bekim Tomçini Përgjegjës i Sektorit të Matjeve Mekanike

Gjatë periudhës shtator 2021-shkurt 2022 u zhvillua projekti i një krahasimi ndër-laboratorik mes laboratorit të presionit të DPM dhe laboratorit të presionit të Agjensisë të Metrologjisë të Kosovës (AMK), me kod identifikimi PRE0422.

Ky projekt u kërkua dhe u propozua nga Laboratori i Matjeve të Presionit të AMK-së. Kërkesa u pranua dhe u miratua nga ana e DPM-së. Në këtë projekt laboratorit pilot ishte Laboratori i Matjeve të Presionit të DPM-së.

Objektivi i këtij krahasimi ndër-laboratorik ishte të kontrollohen aftësitë matëse kalibruese (CMC) në fushën e presionit të laboratorëve kombëtarë pjesëmarrës për të lehtësuar demonstrimin e ekuivalencës metrologjike midis këtyre laboratorëve në Shqipëri dhe në Kosovë si dhe të kontrollojë vlefshmërinë e këtyre aftësive matëse kalibruese. Laboratori i matjeve të presionit, në rolin e laboratorit pilot, ishte përgjegjës për përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm, protokollit teknik, vlerësimin dhe raportimin e rezultateve.

Ky krahasim ndër-laboratorik u organizua në përputhje me EURAMET

Guide No. 4 "EURAMET Guide on Comparisons" 05/2016, si dhe Cox M. G. 2002 Metrologia 39 589-595 "The evaluation of key comparison data".

Standardi transferues, që ishte një sensor presioni hidraulik, u vu në dispozicion nga Laboratori i Matjeve të Presionit të DPM-së. Ky laborator është dhe pronar i kësaj pajisjeje. Matjet u realizuan gjatë periudhës nëntor 2021-janar 2022. Të gjitha matjet dhe llogaritjet për këtë ILC u kryen nga Z. Bekim Tomçini, Specialist i

Laboratorit të Matjeve të presionit në DPM.



**Figura 4.**  
*Montimi i të gjithë sistemit matës të sensorit të presionit*

Standardi transferues i presionit që u përdor në ILC, u transportua nga një laborator në tjetrin në rrugë tokësore, i paketuar në kuti të përshtatshme, për tu mbrojtur nga goditjet mekanike. Të dy laboratorët pjesëmarrës në këtë projekt e kryen transportin e standardit të transferimit në përputhje me afatet kohore të përcaktuara.

Karakteristikat metrologjike të standardit transferues që u përdor në këtë projekt, për matjen e presionit hidraulik janë:

- Emërtimi i pajisjes: Sensor presioni
- Prodhuesi: WIKA
- Modeli: CPT 6400
- Nr. Serisë: 6019324
- Lloji i presionit: Hidraulik
- Saktësia: 0.025%

Matjet u realizuan në përputhje me kërkesat e protokollit teknik të përgatitur në DPM dhe dakordësuar nga të dyja palët si dhe guidave ndërkombëtare për

kryerjen e ILC-ve. Rezultatet e matjeve dhe llogaritja e pasigurisë u dërguan tek laboratorit pilot i DPM-së, laborator i cili kreu vlerësimet dhe llogaritjet përkatëse, deri në finalizimin e raportit të ILC-së.



*Figura 5.*

*Standardi i transferimit të sensorit të presionit*

### Vlera e referencës

Vlera e referencës e përdorur në këtë ILC, përcaktohet nga mesatarja e gabimeve të matjeve të marra nga laboratorit pilot, matje këto të kryera para

dhe pas çdo transferimi nga njëri laborator pjesëmarrës te tjetri, sipas afateve të përcaktuara në protokollin teknik. Në pasigurinë e matjes u mor parasysh një kontribut shtesë për shkak të qëndrueshmërisë dhe stabilitetit të standartit të transferimit gjatë transportit.

### Stabiliteti i standardit transferues

Rezultatet e marra nga DPM për standardin transferues, bazohen në matjet e kryera në fillim dhe pas çdo qarkullimi nga laboratorët pjesëmarrës. Matjet e qëndrueshmërisë së matesit të energjisë kryhen kundrejt standardit referencë MTE PRS400.3 të DPM-së. Nga të dhënat e matjes së qëndrueshmërisë së standardit të transferimit, laboratorit pilot vlerësoi vlerat e lëvizjes së këtij standardi dhe korrigjoi matjet e tij për këtë drift, duke vlerësuar edhe riprodhueshmërinë e tij. Kjo vlerë merret në konsideratë, pasi përcakton stabilitetin e standardit të transferimit. Vlerat e laboratorit pilot merren si mesatare e matur e serive të matjeve të fillimit dhe pas çdo qarkullimi të standardit të transferimit duke llogaritur edhe driftin dhe kontributin e tij të pasigurisë.

### Shkallët e ekuivalencës dhe pasigurisë së pjesëmarrësve

Rezultati i krahasimit raportohet si shkalla e ekuivalencës dhe gabimit të normalizuar midis rezultateve të pjesëmarrësve dhe vlerave të referencës së krahasimit.

Shkalla e ekuivalencës së secilit pjesëmarrës ( $de$ ), është llogaritur:

$$de_i = e_{Lab_i} - e_{DPM_{ref}}$$

–  $e_{Lab_i}$ : gabimi i matësit nga laboratori pjesëmarrës

–  $e_{DPM_{ref}}$ : gabimi i matësit, nga DPM është llogaritur mesatarja e matjeve para dhe pas transportit.

#### Vlerësimi i rezultateve

Vlerësimi i secilit rezultat me vlerën mesatare të ponderuar (vlera referuese) dhe pasiguritë përkatëse të tyre llogariten nga gabimi i normalizuar  $E_n$ :

$$E_n = \left| \frac{\Delta e_{Lab-i} - \overline{\Delta e_{DPM-ref}}}{\sqrt{U_{\Delta e_{Lab-i}}^2 + U_{(\Delta e_{DPM-ref})}^2}} \right|$$

Oë një rezultat të jetë i pranueshëm vlera e  $E_n$  duhet të jetë në përputhje me standartin EN ISO/IEC 17043, ndërmjet vlerës -1 dhe +1.  $|E_n| < 1$ .

Rezultatet e detajuara të ILC-së janë të shprehura në raportin final PRE0422 të këtij projekti.

#### 4. Trajnimi “BIPM- TUBITAK UME project placement”.

**Znj. Iska Kolaveri**  
Përgjegjëse e Sektorit të Elektrikut,  
Termometrisë dhe Lagështisë.

Në periudhën 04-22.10.2021, znj. Iska Kolaveri ishte pjesë e trajnimit “BIPM-TUBITAK UME project placement” i organizuar në institucionin Turk të Metrologjisë, në Gebze, Turqi. Arsyeja e pjesëmarrjes në këtë trajnim ishte vënia në efikasitet dhe pikave fikse dhe standarteve primare të laboratorit të temperaturës së DPM.



**Figura 6.**  
*Kontrolli i SPRT në WTP*

Si rrjedhojë gjatë qëndrimit 3 javor u punua bashkë me kolegët e institutit për:

-optimizimine pikave fikse ITS-90 (pikat fikse Ag dhe Al);

-karakterizimin e HTSPRT-ve. Përmirësimi imatjeve për studimin e qëndrueshmërisë në temperaturë të lartë të SPRT-ve në pikat fikse Ag dhe Al;



**Figura 7.**

*Proçesi i realizimit të matjeve*

-llogaritja e buxhetit të pasigurisë, për të përmirësuar dhe ruajtur gjurmueshmërinë e laboratorit parësor.

Nga ky projekt u përfituan shumë njohuri bazë dhe të domosdoshme në fushën e termometrisë, për kalibrime në laboratorët primare. Gjithashtu praktika është e nevojshme për të gjithë ne, për çdo fushë të metrologjisë në institucione metrologjike.

### **5. Miratimi i akteve nënligjore**

- Udhëzimi i Ministrit Nr.23, datë 01.11.2021 "Për mbajtjen e regjistrimit për mirëmbajtjen dhe verifikimin e instrumenteve matëse ligjërish të kontrolluara".

### **6. Vendimet për autorizim:**

- **VME SHPK**, me nr. Nipt-i L52404015H, me adresë Njësia Bashkiake Nr.5, Rruga "Perlat Rexhepi", Pallati 6, Ap. 20, Tiranë, autorizuar sipas Vendimit Administrativ nr.4, datë 01.10.2021 për "Verifikim të instrumenteve matëse ligjërish të kontrolluar, matëse të energjisë elektrike". Data e hyrjes në fuqi të vendimit është 16.01.2022 ndërsa vlefshmëria e tij është deri në datë 15.01.2026.

- **"SHPRESA – AL" SHPK**, me nr. Nipt-i: K31321021N, me adresë Njësia Bashkiake Nr.9, Rruga "Urani Pano", mbrapa "Veve Center", Pallati Nr.11, Kati 2, Tiranë, autorizuar sipas Vendimit Administrativ nr.05, datë 18.11.2021 për "Verifikim të instrumenteve matëse ligjërish të kontrolluar, cisterna rrugore (autobote)". Data e hyrjes në fuqi të vendimit është 18.11.2021 dhe vlefshmëria e tij është deri më datë 17.11.2025.

- **"3G" SHPK**, me nr. Nipt-i: L27313002C, me adresë Sheshi "2 Prilli", pas Rektoratit të Universitetit të Shkodrës, Shkodër, autorizuar me Vendimin Administrativ Nr.06, datë 28.12.2021 për "Verifikim të instrumenteve matëse ligjërish të kontrolluar, matëse të energjisë elektrike". Data e hyrjes në fuqi të vendimit është 02.04.2022 ndërsa vlefshmëria e tij është deri në datë 01.04.2026.

- **“HYDROPOWER-N” SHPK**, me nr. Nipt-i M17407003G, me adresë Sheshi “2 Prilli”, pas Rektoratit Shkodër, Shkodër, autorizuar me Vendimin Administrativ nr.01, datë 02.02.2022 për “Verifikim të instrumenteve matës ligjërisht të kontrolluar, matës ujë”. Data e hyrjes në fuqi të vendimit është 02.02.2022 ndërsa vlefshmëria e tij është deri në datë 01.02.2026.

- **“METRO - Alb12” SHPK**, me nr. Nipt-i: L24211001V, me adresë Njësia Bashkiake Nr.9, Rruga "Asim Vokshi", Pallati Nr.6, Kati 1, përballë SPAK, Tiranë, autorizuar me Vendimin Administrativ nr.02, datë 28.02.2022 për “Verifikim të instrumenteve matës ligjërisht të kontrolluar, matës ujë”. Data e hyrjes në fuqi të vendimit është 01.03.2022 ndërsa vlefshmëria e tij është deri në datë 28.02.2026.

## **KËSHILLIBOTUES**

**Erinda Piluri, Majlinda Hoxha,  
Stilian Habibi, Dëfrim Bulku,  
Valbona Dina**

### **DREJTORIA E PËRGJITHSHME E METROLOGJISË**

Adresa:Autostrada Tiranë-Durrës, km.8,  
Kashar, Tiranë, SHQIPËRI  
E-mail: metrology@dpm.gov.al  
Web: www.dpm.gov.al